



# Newsletter, KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.5 Shtator,Tetor, Nëntor,  
Dhjetor 2020

## Index:

|            |    |
|------------|----|
| Aktivitete | 2  |
| Aktivitete | 6  |
| Deklaratë  | 11 |
| Aktivitete | 19 |

## KOMISIONERI GAJDA NË PUNIMET E SEMINARIT DY DITOR TË ECRI, KUNDËR RACIZMIT DHE INTOLERANCËS



Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda mbajti një fjalë në punimet seminarit dy ditor të Komisionit të Këshillit të Europës Kundër Racizmit dhe Intolerancës (#ECRI) në të cilin marrin pjesë përfaqësues të institucioneve më të rëndësishme të mbrojtjes së të drejtave të njeriut nga e gjithë Europa.

Komisioneri Dr. Gajda ngriti shqetësimin e trendit rritës të gjuhës së urrejtjes online dhe angazhimin e institucionit të KMD për të luftuar diskriminimin online, me vendime, rekomandime, por edhe me Alencën Pa Urrejtje, të ngritur së bashku me Avokatin e Popullit, Autoritetin Audio-vizual të Medias dhe Këshillin Shqiptar i Medias.

Seminari është ndër aktivitetet më të rëndësishme të ECRI dhe institucioneve të të drejtave të njeriut dhe tema e tij e sivjetshme është "Bashkimi i forcave në rritjen e komunikimit të mesazhit të barazisë dhe diversitetit".

Rritja e kapaciteteve të institucionit të KMD dhe përthithja e praktikave më të mira të ECRI është në synimi të përpjekjes për të luftuar diskriminimin dhe mesazhet e urrejtjes.

### Kuvendi miratoi ndryshimet në Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi



Kuvendi i Shqipërisë miratoi në seancën e sotme plenare projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi” me 95 vota pro, 6 kundër dhe 5 abstenim.

Gjatë diskutimeve në sallën e Kuvendit të Shqipërisë, Nënkryetarja e Kuvendit znj. Vasilika Hysi vuri në dukje se, ndryshimet në Ligj përmbushin:

- Rekomandimet e Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI), sidomos Rekomandimi Nr.2 për organet e barazisë që luftojnë racizmin dhe intolerancën në nivel kombëtar, rekomandimi nr.7, nr. 15.
- Rekomandimet e paraqitura në Raporti i ECRI-t për Shqipërinë (2015) dhe 2020;
- Mbajmë parasysh Strategjinë e Komisionit Evropian “Për barazinë midis burrave dhe grave 2010-2020”;
- Rekomandimin e Komisionit Evropian për Organet Kombëtare të Barazisë, 2018
- Raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë 2019 dhe 2020.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Robert Gajda gjen rastin të falenderojë të gjithë deputetët e Kuvendit të Shqipërisë për angazhimin për të përmirësuar ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, duke vlerësuar të rëndësishme sigurimin e mundësive të barabarta dhe reduktimi i pabarazive në rezultate, duke përfshirë eliminimin e ligjeve, politikave dhe praktikave diskriminuese dhe promovimin e legjislacionit, politikave dhe veprimeve përkatëse në këtë drejtim.

### KMD deklaratë për shoqërimin me forcë të gazetarit gjatë raportimit të një proteste

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi u njoh nga mediat për shoqërimin jo procedural të gazetarit Xhoi Malësia, gjatë raportimit për incidentet në Tiranë. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerëson se përdorimi i forcës ndaj personave që identifikohen si gazetar, të paangazhuar në ngjarje të dhunshme dhe që janë të gatshëm të bashkëpunojnë me autoritetet - është tejkalim i rregulloreve dhe ligjeve që normojnë veprimtarinë e Policisë së Shtetit. Nuk është hera e parë që efektivë të Policisë së Shtetit përfshihen në situata që tejkalojnë përdorimin e ligjshëm të forcës dhe për këto raste kemi reaguar publikisht. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi garanton se institucioni i KMD do të jetë në krah të respektimit të të drejtave të Njeriut dhe fton qytetarët të ushtrojnë të drejtën e tyre në



Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi  
Commissioner for Protection from Discrimination

### Dr. Gajda fjalim në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri



Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda mori pjesë në çeljen e Festivalit Ndërkombëtar të Filmit për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri (IHRFFA), programi përfshin 3 filma premierë, me tematikë komunitetin LGBTI+ dhe përjetimet e tyre në realitete të ndryshme e të vështira në botë.

Netët e filmit queer rikthehen në Tiranë në datat 17, 18 dhe 19 Shtator.

Filmat tregojnë aspekte të ndryshme të përballjes së personave queer me përditshmërinë e tyre, nga historia e një djali iranien në Gjermani, i cili përjeton lirinë e të qenit vetvetja për herë të parë njëkohësisht me vështirësitë integritetit në një vend të huaj, te realiteti i vështirë në Çeçeni, me kampet e persekutimit për personat LGBTI+ dhe mohimin e ekzitencës së tyre.



### KMD deklaratë për gjuhën denigruese të përdorur në një takim publik në Kuvend

Një incident i pakëndshëm është regjistruar gjatë mbledhjes së djeshme të Komisionit për Integrimin Europian në zyrat e Kuvendit të Shqipërisë.


Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ndjehet i keqardhur për komunikimin jo etik, diskriminues të përdorur gjatë një takimi publik online. Por kjo dëshmon edhe njëherë tjetër që institucionet publike nuk janë imune nga Diskriminimi apo gjuha e denigruese, si dhe paraqet nevojën për aktivitete ndërgjegjëse.

Në këtë kontekst, institucioni i KMD mirëpret zbatimin e kodeve të etikës, rregulloreve të posaçme brenda institucioneve publike dhe nxit Kuvendin për marrjen e masave me qëllim mospërsëritjen e rasteve të tilla që shqetësojnë komunitete të ndryshme në shoqërinë tonë.





## KMD konstatoi diskriminim të punëtorëve të Albpetrol për diferencimin në pagë



Një përfaqësi e naftëtarëve të Fierit kanë depozituar një ankesë pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ku pretendonin diskriminim për pagën nga kompania "Albpetrol".

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka konstatuar diskriminim në pagë për punonjësit e administratës dhe ka vendosur të detyrohet punëdhënësi të korrigjoj praktikën diskriminuese për punonjësit dhe çdo punonjësi ti paguhet diferenca e pagës së papaguar.

Institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi po ndjek me përgjegjshmëri dhe vëmendje çështjen.

Dera e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është i hapur jo vetëm për çdo grupe shoqëror/vulnerabël, por edhe për qytetarë që pretendojnë se janë të diskriminuar për çfarëdolloj shkak apo kanë dijeni për ngjarje që çenojnë dinjitetin e Njeriut.

## KMD konstatoi diskriminim për pacientin e shëndetit mendor në IEVP Krujë

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstaton diskriminim të drejtpërdrejtë për pacientin e shëndetit mendor A. B. dhe gjithë pacientëve të sëmurëve të shëndetit mendor si dhe urdhëron marrjen e masave nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Drejtësisë dhe Prokuroria E Përgjithshme.

Shoqata Together for Life ka paraqitur një Ankesë për diskriminimin e pacientit A. B., i cili vuan nga sëmundja mendore e "Skizofrenisë", i cili ka kryer një vepër penale. Për shkak të gjendjes mendore, Gjykata ka pushuar gjykimin dhe ka dhënë ndaj tij masën mjekësore "Mjekim i detyruar në një institucion psikiatrik". Në kundërshtim me ligjin dhe vendimin e gjykatës, shtetasi A. B., është trajtuar që nga viti 2001 në IVSHB Tiranë dhe në IEVP Krujë (Zahari).

Aktualisht janë rreth 275 shtetas më sëmundje të shëndetit mendor që dyshohet apo që kanë kryer një vepër penale për shkak të sëmundjes së rëndë mendore të cilët mbahen në kushte johumane, degraduese dhe të diskriminuara në burgjet e mësipërme dhe jo në një institucion të posaçëm psikiatrik në varësi të MShMS.



### KMD Fier pjesë e takimeve të Shoqërisë Civile për problematikat e komunitetit



Zyra e KMD Rajonale Fier e përfaqësuar nga znj. Aidana Hyka mori pjesë në takimin e zhvilluar nga Qendra Rinore "Epoka e Re" në kuadër të projektit POP (përballje e ofertave politike), e cila është një nismë e rrjetit të 11 organizatave të shoqërisë civile shqiptare që në 2013. Focus grup i këtij takimi ishin gratë, në lidhje me përmbushjen e kontratës sociale ≠ POP, nënshkruar nga Bashkia Fier. Takimet do të vijojnë edhe me të rinjtë dhe me grupe të marginalizuara të kësaj bashkie.

Takimi ishte bashkëbisedim në lidhje me problematikat e ndryshme me të cilat përballlet komuniteti si dhe mënyra se si është ndertuar sistemi për tu ardhur në ndihmë qytetarëve veçanërisht grupeve më vulnerabel të shoqërisë, në këtë kohë pandemie.

Përfaqësuesja e Zyrës Rajonale Fier u përfshi në diskutim dhe informoi për rolin dhe funksionin e Institucionit të KMD si edhe ofroi mundësi që disa nga problematikat e diskutuara mund të referohen si raste pranë KMD për të marrë zgjidhjen që KMD ofron në bazë të ligjit dhe kompetencave të veta.

### KMD Shkodër takim me zyrtarë të Shërbimeve sociale të Bashkisë për të shkëmbyer info

Në kuadër të mbarëvajtjes së bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacioneve, Specialistja e Zyrës Rajonale Shkodër të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi znj. Filomena Bujarja realizoi një takim me drejtoreshen e Shërbimeve Sociale në qytetin e Shkodrës znj. Valbona Tula. Takimi u fokusua në ankesat e qytetarëve që kanë të bëjnë me veprimtarinë e Drejtorisë Rajonale Shkodër të Shërbimit Social dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm për të promovuar barazinë dhe mos diskriminimin.



### Komisionet parlamentare miratojnë amendimet e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut miratoi me datë 25 shtator projektligjin: "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin "Për mbrojtjen nga diskriminimi". Gjatë shqyrtimit të projektligjit, i cili ishte miratuar më herët në parim, ishin ftuar të merrnin pjesë: Robert Gajda, Komisioner për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Klajd Karameta, zëvendësministër i Drejtësisë dhe Besmir Beja, Drejtor i Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë.

## KMD Shkodër në seminarin: Mbrojtja e konsumatorëve dhe vetëqeverisja vendore



Përfaqësuesja e zyrës së Komisionerit për mbrojtjen nga Diskriminimi në Shkodër, znj. Filomena Bujarja mori pjesë në seminarin 3 ditor mbi " Mbrojtja e konsumatorëve dhe vetëqeverisja vendore", lidhur me legjislacionin në fuqi që mbron të drejtat e konsumatorit, si mund të ankohemi dhe ku duhet të ankohemi në rast të shkeljes së këtyre të drejtave.

Kjo nismë kërkon angazhimin e kontributin konkret si dhe partneritet me organizatat e shoqërisë civile për fuqizimin e konsumatorëve në nivel vendor në kuadër të ndryshimeve ligjore.

## KMD Fier në promovimin e e Qendrës për Ndihmë Ligjore Falas për Komunitetet në Nevojë

Përfaqësuesja e Zyrës Rajonale të KMD në Fier znj. Aidana Hyka mori pjesë, sëbashku me aktorët lokalë në promovimin e Qendrës për Ndihmë Ligjore Falas për Komunitetet në Nevojë, pranë Gjykatës së Rrethit Fier. Takimi kishte në fokus shkëmbimin e eksperiencave dhe forcimin e partneriteteve. Pjesëmarrësit,

përfaqësues nga shërbimet sociale, aftësia e kufizuar, mekanizmi i referimit të rasteve të dhunës në familje, OJF që punojnë për grupet e marginalizuara, shprehën rëndësinë e këtij shërbimi në Bashkinë Fier si dhe nevojën për të bashkëpunuar në kuadër të referimit pranë qendrës të rasteve në nevojë për shërbim ligjor. Në përfundim të takimit u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet FShDPAK, Bashkisë Fier dhe Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, Fier.

Gjatë fjalës së saj, Specialistja e ZR Fier përmendi veprimtarinë e Institucionit të KMD, shpjegoi Ligjin e Mbrojtjes nga Diskriminimi dhe procedurat e një ankese.

ZR Fier theksoi rëndësinë e bashkëpunimit me Zyrën Ligjore Falas si edhe inkurajoi dhe bashkëpunim në nivel vendor duke bërë të mundur përcjelljen e informacionit si potencial në luftën kundër diskriminimit dhe promovimin e barazisë dhe mundësive të barabarta, e cila mund të realizohet nëpërmjet aktiviteteve të përbashkëta ndërgjegjëse.





## Monitorim i zbatimit të konventës ndërkombëtare për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara



Përfaqësuesi i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, z.Darjan Konomi mori pjesë në një takim që inicioi projektin ERCI. Ky projekt që shtrihet në shumë vende synon pjesëmarrjen aktive të personave me aftësi të kufizuara, si dhe monitorimin e zbatimit të konventës ndërkombëtare për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në vende si Hungaria, Polonia, Republika Çeke dhe Shqipëria.

Një nga çështjet më të vështira për t'u zbatuar duket se është vendim-marrja e mbështetur por dhe përcaktimi i aftësisë për të vepruar. Është e nevojshme që të krijohet një task force me grup ekspertësh shqiptar dhe të huaj që do marin për sipër të sjellin njëmodel të qendrueshëm dhe të zbatueshëm në lidhje me këto dy çështje pasi sipas konventës çdo individ është i lirë të vendosi sipas dëshirës së tij.

Në këtë kontekst legjislacioni shqiptar ka nevojë për përmirësime pasi edhe pse parashikon vendim-marjen e mbështetur ka nmjë klauzolë e cila përcakton se mendimi i individit me aftësi të kufizuara nuk meret parasyesh gjithnjë, por meret parasyesh ajo që është më e mira për të. Në fjalën e tij Zoti Konomi tha “Unë dua të përshëndes singërisht

këtë aktivitet edhe në emër të Komisionerit. Sfidat për zbatimin e Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e personave me aftësi të kufizuara janë të shumta. Unë do t'a nisja nga përshtatshmëria, është një faktor kyç dhe thelbësorë për përfshirjen aktive sociale të personave me aftësi të kufizuara. Në lidhje me këtë si KMD kemi një praktikë të mirë pasi kemi ofruar zgjidhje që personat me aftësi të kufizuara të mund të pajisen me mjete identifikimi në ambiente të përshtatura për t'a dhe pa asnjë pengesë.

Ne arritëm këtë sepse shoqata “Së Bashku” na u drejtua dhe na kërkoi zgjidhje në bazë të kompetencave tona. Dhe zgjidhja ishte konkrete, nuk kërkonte para, por vullnet të mirë e mendësi. Gjithashtu ne jemi në djeni të një urdhëri të ddhënë nga Ministeria e Infrastrukturës përpërshtatjen e ambienteve të të gjitha godinave publike. Do e monitorojmë këtë fakt, është një ngarekomandimet tona i cili doli nga problematikat e hasura. KMD gjithashtu ka arritur të zgjidh problemin e personave që vuajnë nga hemofila, ata fal një rekomandimi të KMD marrin shërbimet në qytetet e tyre.

KMD ka pasur gjithashtu përfshirje aktive në vendosjen e mësuesve ndihmës në arsimin 9 vjeçar dhe atë të mesëm duke ju përgjigjur ankesave të qytetarëve, duke i ndjekur, dhe duke ofruar zgjidhje konkrete. Kjo tregon se kur qytetarët apo shoqatat drejtohen pa paragjykim, por me besim instancave përkatëse zgjidhje ka. Sa i përket Jetesës së pavarur ne kemi modele të sukseshme edhe në Shqipëri, po ashtu kemi dhe qendra ditore të cilat kanë filluadhe ofrojnë trajnime për vendm-marrje të mbështetur që nuk është një sfidë vetëm për Shqipërinë,por për gjithë botën.

**KMD mori pjesë në dekorimin e aktivistit të shoqërisë Civile nga presidenti i Republikës**



Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda mori pjesë në një ceremoni solemne të organizuar me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Shkopit të Bardhë, në të cilin Presidenti i Republikë Ilir Meta vlerësoi me Titullin “Për Merita të Veçanta Civile” zotin Emiliano Lule: “Për kontributin e tij të madh në përmirësimin e jetës së mijëra njerëzve që nuk shikojnë; si aktivist i shoqërisë civile si dhe për ndjenjën e thellë të solidaritetit drejt gjithë komunitetit të personave me aftësi të kufizuara”.

Gjithashtu, Kreu i Shtetit çmoi me Titullin “Mjeshtër i Madh” skenaristin Kliton Gilani: “Në shenjë vlerësimi për kontributet e dhëna si skenarist në fushën e kulturës dhe të kinematografisë shqiptare.



**"Statusi i Punësimit të Grave dhe Vajzave në Shqipëri dhe Kosovë, me praktikë më të mira nga rajoni"**


Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda mori pjesë në Forumin e Hapur Rajonal 2 ditor me temë "Statusi i Punësimit të Grave dhe Vajzave në Shqipëri dhe Kosovë, me praktikë më të mira nga rajoni" - të organizuar nga Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (GADC) dhe Democracy for Development (D4D).

Pjesë e këtij forum të hapur rajonal ishin përfaqësues të institucioneve kryesore nga Kosova dhe Shqipëria.





## KMD Takim online mbi gjuhën e urrejtjes dhe diskriminimin në media




Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda mori pjesë në takim online mbi gjuhën e urrejtjes dhe diskriminimin në media, prezantim i gjetjeve të monitorimit të medias.

Takim online mbi gjuhën e urrejtjes dhe diskriminimin në media, prezantim i gjetjeve të monitorimit të medias.

Organizatrat e shoqërisë civile "Historia Ime" dhe "Pro-LGBT" prezantuan gjetjet e raportit të monitorimit të medias mbi gjuhën e urrejtjes dhe asaj diskriminuese.

Së shpejti, do të publikohet dhe raporti i plotë i monitorimit në dy gjuhë, shqip edhe anglisht, të cilin do të mund ta aksesoni online përmes website t [www.historia-ime.com](http://www.historia-ime.com).




## KMD në Media për ndryshimet në Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda ishte i ftuar në emisionin "Për të fol" në ScanTv për të biseduar rreth ndryshimeve në "Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi", për risitë dhe mekanizmat që ofrojnë ndryshimet ligjore për qytetarët, për promovimin e barazisë dhe mos diskriminimin për disa shkaqe të reja, siç janë:

Shkak Diskriminimi për "Shtetësinë", "Hiv Aids", "Karakteristikat e seksit" në dallimin mes gjinisë/seksit.

Ligji është i plotë me format e reja të diskriminimit siç "Diskriminimi i shumëfishtë", "Shqetësimi seksual", "Gjuha e urrejtjes", "Segregimi", "Diskriminimi i strukturuar".

Për herë të parë në këtë ligj sanksionohet që të gjitha organet publike duhet të jetë të përfshira në promovimin e barazisë.



## Administrata diskriminuesi më i madh—Dr. Gajda infervistë për Reporters Albania



Kategoritë në nevojë vijojnë ende të diskriminohen për të marrë një shërbim publik pranë institucioneve publike ndërkohë që diskriminimet vijojnë të mbeten “bindjet politike”, “etnia ose raca”, shtatzania dhe qytetarët me aftësi ndryshe”.

Community Reporters Albania, ditën e enjte, intervistoi kreun e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Z.Gajda për të kuptuar shkaqet e këtyre vendimeve.

Z.Gajda tregon se:” administrata mbetet diskriminues më i madh, edhe pse ka një rritje të biznesit privat, si shkak prevalon bindjet politike, por ka dhe arsye të tjera që ne kemi konstatuar, gjendja arsimore, gjendja shëndetësore por edhe leja lindjes”.

Sipas kërkimeve dhe të dhënave që siguroi C.R.A rezulton se vendimet që KMD ka marrë si “Diskriminim” rezultojnë të jenë në Bashkinë Tiranë, i pyetur sesi reagojnë subjektet kur ka një vendim diskriminim ndaj tyre, Z.Gajda tregon se: “Institucionet nuk e pranojnë, por më pas kjo del gjatë hetimit, por pas pandemisë institucionet e neglizhojnë dhe nuk japin informacion duke e lidhur që nuk kanë staf për shkak të pandemisë, pas këtyre procedurave

kur nuk jepet informacion ne vendosim gjobë”


Çfarë ndodh kur ka një vendim diskriminimi, kush janë hapat e tjera si dhe zbatohet vendimi ?

“Kur kemi vendim diskriminimi, nuk vendoset direkt gjoba, konstatohet në radhë të parë më pas vendoset edhe sjellja që duhet të ndjekë subjekti, kur kemi të bëjmë më raste punësimi, në kërkojmë që të rikthehet në punë sepse bëhet fjalë për ndërprerje të vendit të punës, në pjesën më të madhe mbi 90% e rasteve shkojnë në gjykatë, e cila vendos nëse do mbaj në fuqi vendimin e Komisionerit apo jo, ajo që vejmë re është se ka një ndarje në vendimet e gjykatave, pasi një pjesë gjykojnë që nuk duhet të rikthehen në punë, por ka dhe gjyqtarë që vendosin sipas vendimit të Komisionerit për ta rikthyer në punë, por prevalon praktika gjyqësore që nuk e pranon rikthimin në punë për punonjësit e administratës publike, paçka se kodi i punës parashikon se ekziston rikthimin në punë”.

Por ka dhe institucione që nuk e zbatojnë vendimin e komisionerit, gjatë kërkimeve rezultojnë se Ministria e Brëndshme nuk ka zbatuar një nga vendimet e komisionerit por edhe nuk e ka ankimuar, në këto raste sipas KMD veprohet me gjobë.

Pas hetimit të kryer nga KMD rezultoi se: -“në rastin konkret me ricikluesin, është konstatuar, që ka një vakum rregullator në bashkinë e Tiranës jo me mbetjet, por me mjetet që i sekuestrohet, nuk e ka të qartë me procedurën si veprohet, nuk ka një implant rregullator sesi duhet të bëhet sekuestrimi, nuk mbahet proces-verbal dhe sidomos vënia në dispozicion të qytetarëve të aktit administrative që ai të ketë mundësi të ankimojë në gjykatë”.

### KMD monitoron gjuhën diskriminuese në MEDIA



Institucioni i Komisionerit për mbrojtjen nga Diskriminimi mirëpreti vendimin e televizionit Kombëtar Top Channel për të marrë masa për ndreqjen e situatave diskriminuese dhe sjelljeve jo sociale që cënojnë dinjitetin e njeriut.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori sot ankesa nga organizata të shoqërisë civile për trajtimin e kësaj çështjeje, si dhe dëshiron të bëjë të ditur se respektimi i të drejtave të Njeriut, promovimi i barazisë dhe ndreqja e akteve diskriminuese janë në fokus të punës ditore të Institucionit.

### KMD i bashkohet fushatës botërore për të përkujtuar 75 vjetorin e themelimit të OKB

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i është bashkuar fushatës botërore për të përkujtuar Ditën e Kombeve të Bashkuara dhe 75 vjetorin e themelimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

OKB është organizata e parë ndërkombëtare për të cilën shqiptarët në tërësi gëzojnë respekt të veçantë për kontributin e dhënë në përmirësimin e Demokracisë, të Drejtave të Njeriut dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm për të

fituar disa beteja sociale dhe ekonomike.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi çmon Zyrën e OKB në Tiranë (PNUD, UNICEF) dhe stafin e saj për bashkëpunimin e qëndrueshëm në arritjen e objektivave të barazisë dhe luftës ndaj diskriminimit.

### KMD në tryezën e rrumbullakët mbi rekomandimet e raportit të ECRI-t

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda mori pjesë në tryezën e rrumbullakët organizuar në Tiranë për të diskutuar me aktorët kyç rekomandimet e raportit të ECRI-t.

Aktualisht iniciativat e përbashkëta në Shqipëri të BE dhe Këshillit të Evropës “Promovimi i Diversitetit dhe Barazisë” dhe “ROMACTED - Promovimi i Qeverisjes së Mirë dhe Fuqizimit të Komunitetit Rom në Nivel Vendor” po punojnë me autoritetet vendase për të adresuar mbrojtjen e minoriteteve, promovimin e të drejtave të komunitetit LGBTI dhe lufta kundër gjuhës së urrejtjes në përputhje me standardet dhe rekomandimet e Këshillit të Evropës.





## Dr. Gajda prit në takim ambasadorin e Austrisë në Tiranë, Dr. Christian Steiner



Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda prit në selinë e institucionit, Ambasadorin e Austrisë në Tiranë, Dr. Christian Steiner.

Komisioneri Dr. Gajda e informoi ambasadorin Dr. Steiner mbi veprimtarinë e institucionit e KMD për luftimin e diskriminimit dhe gjendjen aktuale të komuniteteve, grupeve vulnerabël dhe minoritetet etnike në raport me ankesat pranë zyrave tona në territor.

Nga ana e tij Ambasadori Dr. Christian Steiner vlerësoi rolin e institucionit të Komisionerit në kuadër të kornizës insitucionale për të mbrojtur të drejtat e Njeriut.

## Dr. Gajda prit në takim zv. Ambasadorin e Hollandës në Shqipëri, z. Rogier Nouwen



Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda prit në një takim zv. Ambasadorin e Hollandës në Shqipëri, z. Rogier Nouwen.

Komisioneri Dr. Gajda e informoi zv.ambasadorin Nouwen për veprimtarinë e KMD gjatë vitit të fundit, duke vënë theksin tek monitorimi i situatës pandemike në vend që prek komunitetet dhe grupet vulnerabël.

Nga ana e tij, zv. Ambasadorin Nouwen ka përgëzuar lidhshimin e KMD për ndryshimet në Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe qëndrimin pro aktiv për marrje ekspertizë, opinione dhe komente nga palët e interesuara, përfshirë ambasadën holandeze.



## KMD Gajda takim me drejtor i Shkollës së Magjistraturës, Arben Rakipi

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda zhvilloi një takim me Dr. Arben Rakipin, drejtor i Shkollës së Magjistraturës, në kuadër të bashkëpunimit dhe ofrimit të ekspertizës të specializuar për magjistratët e rinj, të cilët nesër do të promovojnë barazinë para ligjit dhe mosdiskriminim.

## Luftimi i diskriminimit racor dhe intolerancës në Shqipëri



Komisioni Evropian i Këshillit të Evropës kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI) në bashkëpunim me Avokatin e Popullit dhe Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi në Shqipërisë organizoi në Tiranë, një tryezë të rrumbullakët online mbi “Luftimin e diskriminimit racor dhe intolerancën në Shqipëri”.

Robert Gajda, Komisioner për Mbrojtjen nga Diskriminimi gjatë fjalimit të tij trajtoi rëndësinë e politikave dhe iniciativave publike në luftën kundër diskriminimit racor dhe intolerancës. “Roli i shtetit në këtë proces është të krijojë përmes politikave, veprimeve dhe iniciativave të qëndrueshme, mundësi reale për grupet më të pafavorizuara në mënyrë që mundësi të tilla të vendosen në mënyrë efektive dhe të garantojnë barazi thelbësore”, shtoi Gajda.

Takimi vijoi me seksionet tematike, ku pjesëmarrësit trajtuan disa nga sfidat kryesore në lidhje me ndjekjen dhe adresimin e rekomandimeve në raportin ECRI të vitit 2015, siç janë zhvillimi dhe zbatimi i kuadrit ligjor për luftimin e racizmit dhe diskriminimit racor; si dhe zgjidhjet për problemet e strehimit të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane.

**"E Drejta e Protestës në Kohë Pandemie" -**

## KMD merr pjesë në takimin e OSHC

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda mori pjesë në një takim me aktivistë të Shoqërisë civile mbi temën: "E Drejta e Protestës në Kohë Pandemie", të organizuar nga Qendresa Qytetare, CLR dhe Olaf Palme Center së bashku me aktorët institucionalë, si KMD dhe Avokati i Popullit.

Kufizimi absolut i të drejtës për të protestuar ishte shqetësimi që sot patëm mundësi t'ia adresojmë Kryetares së Komitetit të Ekspertëve dhe zv. Ministres së Shëndetësisë, znj. Rakacolli.

Gjate pandemisë Policia e Shtetit ka mohuar të drejtën e protestës qindra qytetarëve si edhe ka shpërndarë forcërisht me dhjetra protesta të organizuara në të gjithë vendin - për Komisionerin Dr. Gajda kanë qenë akte shqetësuese dhe jo proporcionale, si dhe për këtë arsye Institucioni i KMD ka bërë deklarata, tërheqje vëmendje publike dhe rekomandime pranë Këshillit të Ministrave.



## “Luftojmë dezinformimin dhe rrisim transparencën dhe llogaridhënien”



Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda mori pjesë në trajnimin dy-ditor me organizata të shoqërisë civile dhe gazetarë në kuadër të projektit “Luftojmë dezinformimin dhe rrisim transparencën dhe llogaridhënien në sistemin”, të organizuar nga Shoqata “Together for Life” në bashkëpunim me Birn Albania.


Në trajnim morën pjesë 15 organizata të shoqërisë civile dhe 15 gazetarë nga zona të ndryshme të vendit që morën informacion lidhur me funksionimin e sistemit shëndetësor, buxhetimin e tij, si dhe rolin e institucioneve të pavarura në rritjen e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

### KMD histori suksesi për gjithëpërfshirjen për artit të grupeve vulnerabël

Përfaqësuesi i komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, z. Darjan Konomi mori pjesë në një takim të Equinet (rrjeti i organizatave të barazisë në Evropë) mbi strategjitë e komunikimit. Në këtë takim zoti Konomi u përqendrua tek arti si mjet alternativ i

komunikimit.

Në fjalën e tij zoti Konomi tha “Idea e artit si mjet integrimi dhe komunikimi nisi për mua 10 vite më parë teksa punoja në një qendër ditore që ofron shërbime multi-disiplinore për persona me aftësi të kufizuara intelektuale. Fillimisht kishte një funksion terapeutik. Me këtë unë dua të them se qëllimet ishin 3, e para të shikonim sa do rritej përmes teatrit përqendrimi i personave me aftësi të kufizuara intelektuale pjesëmarrës në trupë, e dyta ishte të shikonim si do të ishte ndërveprimi mes tyre dhe a do punonin në grup. Në fund të shfaqjes u vërejtë se në të tre këto komponent që përmenda më lart patëm sukses. Sidomos do theksoja pjesën e përgjegjshmërisë nga ana e personave me aftësi të kufizuara intelektuale. Vështirësia ishte të bindnim prindërit e personave me aftësi të kufizuara se fëmijët e tyre mundën, por mendoj se ja dolëm. Avantazhet e komunikimit përmes artit janë të shumta. Grupet vulnerabël kanë mundësinë të festojnë diversitetin e tyre përmes artit. Siç kanë theksuar Sibers dhe Swain në një studim të kryer për lëvizjen artistike të personave me aftësi të në Bretaninë e Madhe.





### KMD në takim me pedagogë dhe studentë të Universitetit "Barleti" në Tiranë



Në ditën Ndërkombëtare për paqe dhe zhvillim, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda në bashkëpunim me Institutin Shqiptar për Çështje Publike #AIPA, organizoi një tryezë bashkëbisedimi online me pjesëmarrjen me pedagogë dhe studentë të Universitetit "Barleti" në Tiranë.

Takimi u përshëndet nga Rektori i Universitetit, Prof. Dr. Agim Kukeli. Fjala e Z. Gajda theksoi rëndësinë e garantimit të paqes dhe të zhvillimit të qëndrueshëm mbi bazën e parimit të barazisë si edhe të mosdiskriminit. Me shembuj ilustrues nga veprimtaria e Komisionit, Z. Gajda mundësoi një bisedë interaktive me studentët dhe pedagogët.

### “Roli i Mekanizmit Parlamentar në Fuqizimin e Institucioneve të Pavarura”

Institucionet e pavarura të të drejtave të njeriut, Kuvendi dhe shoqëria civile diskutojnë rreth rëndësisë së rritjes së rolit të IKDNJ

Shoqata “Together for Life” (TFL), organizoi

Konferencën “Roli i Mekanizmit Parlamentar në Fuqizimin e Institucioneve të Pavarura”, në të cilën prezantoi gjetjet e studimit të realizuar në kuadër të Projektit “Evropa Respekton të Drejtat e Njeriut”, mbështetur nga EU Albania, nëpërmjet programit IPA 2015, i cili menaxhohet nga Ministria e Financave (CFCU Albania). Për Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Z. Robert Gajda, pjesëmarrës në Konferencën e organizuar nga TFL, “me ngritjen e mekanizmit ka sinjale pozitive nga institucionet qendrore të cilat i zgjidhin çështjet në favor të qytetarit që në fazën e hetimit, pa detyruar vendimmarrjen e Komisionerit.”

“Ndërsa për vendimet e Komisionerit qasja e institucioneve është përmirësuar, u shpreh Komisioneri Gajda, për rekomandimet që Zyra e Komisionerit lëshon për çështje të caktuara që prekin një grup të gjerë individësh ende institucionet kanë të njëjtën qasje.”

Në Konferencë morën pjesë edhe përfaqësues të institucioneve të tjera të pavarura, përfaqësues të shoqërisë civile, grupeve të interes, përfaqësues të medias, etj. Studimi vë në dukje se në përgjithësi është rritur vendimmarrja e institucioneve të pavarura të pranuar dhe zbatuar nga institucionet qendrore, por problematikë vazhdon të jetë numri i lartë i rekomandimeve të refuzuara prej tyre.



### KMD Shkodër në Qendren për Zhvillim Ditor në qytetin e Lezhës



Përfaqësuesja e zyrës Rajonale KMD Shkodër znj.Filomena Bujarja realizoi një takim me përfaqësues të Bashkisë Lezhë dhe në Qendren për Zhvillim Ditor në qytetin e Lezhës.

Qëllimi i këtyre takimeve ishte prezantimi dhe nxitja e bashkëpunimit ndërmjet Zyrës Rajonale Shkodër dhe Drejtorisë së Sherbimeve Sociale të Bashkisë Lezhë dhe jo vetëm. Në këtë takim u diskutua dhe për mundësinë e realizimit të një marrveshjeje bashkëpunimi ndërmjet KMD dhe Bashkisë Lezhë. Në këtë takim moren pjesë Drejtoresha e Sherbimeve Sociale të Bashkisë Lezhë , znj.Suada Nekaj - Specialiste e Barazisë Gjinore dhe kundër Dhunës në Familje si dhe përfaqësues të tjerë të kësaj drejtorie.

Përfaqësuesja e Zyrës Rajonale Shkodër realizoi dhe një vizitë në Qendrën për Zhvillim Ditor në Bashkinë Lezhë, ku u takua me drejtoreshen e kësaj qendre znj.Marjana Tahiri .Në këtë vizitë u njohem me ambientet e kësaj qendre , punimet e fëmijëve dhe aktivitet

që ato kanë realizuar ndër vite .Gjithashtu u diskutua nëse ka pasur problematika të diskriminimit të referuara nga prinderit, lidhur me këtë znj.Tahiri u shpreh se nuk ka pasur .Në përfundim të takimit në këtë qender Znj.Bujarja u takua dhe me fëmijët dhe stafin e qendrës.

### KMD FIER takim me Përfaqësuesen e Avokatit të Popullit në Vlore

Përfaqësuesja e zyrës Rajonale KMD Fier, znj. Aidana Hyka zhvilloi një takim me Përfaqësuesen e Avokatit të Popullit në Vlore, në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve. Përfaqësuesja e AP Vlorë u njoh me ndryshimet në ligjin " Për Mbrojtjen nga Diskriminimi".

Më tej takimi vazhdoi me daljen në terren për të shpeërndarë fletpalosje dhe ligjin, duke informuar dhe sensibilizuar qytetarët, në çështjet që lidhen me diskriminimin duke dhënë një mesazh për barazi dhe mosdiferencim midis njerëzve.



### KMD marrëveshje Bashkëpunimi me Institutin Shqiptar për Çështje Publike, AIPA



Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda nënshkroi një "Marrëveshje Bashkëpunimi" me Institutin Shqiptar për Çështje Publike, AIPA, pranë Universitetit "Barleti" në Tiranë.

Marrëveshja synon bashkëpunimin dhe bashkërendimin e nismave të ndryshme, aktiviteteve trajnuese dhe informuese mes personelit akademik dhe specialistëve të KMD në fushën e të Drejtave të Njeriut, promovimin e barazisë dhe luftimin e diskriminimit.



### "Programi i Angazhimit Qytetar për Përparimin e të Drejtave të Komunitetit LGBTI në Shqipëri, Politika dhe Përfaqësimi"

Përfaqësuesja e Zyrës Rajonale KMD Shkodër, znj. Filomena Bujarja mori pjesë në takimin me temë: "Programi i Angazhimit Qytetar për Përparimin e të Drejtave të Komunitetit LGBTI në Shqipëri, Politika dhe Përfaqësimi".

Ky takim/trajnim u organizua nga Organizata Open Mind Spectrum Albania (OMSA), me mbështetjen e NDI dhe Victory Institute, organizatë e cila po realizon një program me fokus angazhimin qytetar, të drejtat, përfaqësimin dhe politikat për promovimin e diversitetit dhe të barazisë në Shqipëri takimi i radhës u bë në Shkodër me përfaqësues të Forumeve Rinore të Partive Politike në qytetin e Shkodrës dhe me pjesëmarrjen e Zyrës Rajonale Shkodër të KMD. Ky program synon të nxisë gjithëpërfshirjen brenda partive politike dhe të zbusë diskriminimin dhe stigmën ndaj komunitetit LGBTI.





### KMD Korçë në aktivitetin "Diskriminimi me bazë gjinore dhe dhuna në Shqipëri"



Përfaqësuesja e zyrës Rajonale të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në Korçë, znj Etleva Tare, mori pjesë në aktivitetin me temë "Diskriminimi me bazë gjinore dhe dhuna në Shqipëri", organizuar nga Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim dhe Drejtoria e Kujdesit Social.

Në këtë takim morën pjesë përfaqësues të zyrës rajonale të Punësimit, Inspektoriatit i Kontrollit të Punës si dhe përfaqësues nga Bashkia Korçë.

Në fjalën e saj znj Tare, midis të tjerash theksoi rëndësinë e ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi në vendin e punës, llojet e diskriminimit, ndryshimin e tij, si dhe rezultatet e arritura në lidhje me ankesat që janë bërë në fushe në punësimit.

### Koordinimi për adresimin, raportimin dhe menaxhimin e rasteve të diskriminimit në punë".

Përfaqësuesja e zyrës Rajonale KMD në Shkodër znj.Filomena Bujarja mori pjesë në Workshopin me temë: "Koordinimi për adresimin, raportimin dhe menaxhimin e rasteve të diskriminimit në punë".

Ky takim ishte takimi i radhës i Komitetit Ad-hoc kunder diskriminimit në punë i ngritur për të vepruar në Bashkinë e Lezhës i cili ka si qëllim advokimin për përmirësimin e reagimit institucional ndaj diskriminimit me bazë gjinore në punë nëpërmjet ndarjes së praktikës në Bashkinë Lezhë.

Në këtë takim moren pjesë përfaqësues të institucioneve lokale në Bashkinë Lezhë. Znj.Bujarja ndër të tjera ndau me pjesmarrësit informacion lidhur me procedurën e ndjekjes së ankesave nga KMD dhe punën e Zyrës Rajonale Shkodër.

Ky takim u organizua nga Qendra Komunitare "Sot Per Te Ardhmen" Bashkia Lezhe



## KMD Marrëveshje Bashkëpunimi me Autoritetin e Mediave Audiovizive



Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Autoriteti i Mediave Audiovizive nënshkruajnë Memorandum Mirëkuptimi!.

Me qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërinstytucional, me fokus rëndësinë e garantimit të mbrojtjes nga diskriminimi në fushën e shërbimeve audiovizive Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nënshkruajnë memorandum mirëkuptimi.

Ky Memorandum mirëkuptimi synon institucionalizimin e bashkëpunimit dhe përcaktimin e rregullave dhe mënyrave brenda të cilave Institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Autoriteti i Mediave Audiovizive, do të zhvillojnë marrëdhëniet e tyre institucionale në kuadër të punës së përbashkët për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut, për çështje të interesit të përbashkët që lidhen me zbatimin e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi në fushën e mediave audio dhe/ose audiovizive.

Gjatë takimit të organizuar në ambientet e

Autoritetit të Mediave Audiovizive, Z. Gentian Sala, Kryetar i Autoritetit të Mediave Audiovizive, theksoi se "...respektimi dhe mbrojtja e grupeve të marginalizuara është në fokus të punës sonë ndaj dhe forcimi i bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve tona do të jetë një vlerë e shtuar në zgjidhjen e atyre problemeve që has ky kontingjent i shoqërisë".

Z. Robert Gajda, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi u shpreh se "... mbrojtja e të drejtave themelore të njeriut, siç është dhe mbrojtja nga diskriminimi në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare, është një e drejtë legjitime e qytetarëve shqiptarë".

## KMD FIER çel Ditët e Hapura Kunder Diskriminimit në Berat

Përfaqësuesja e zyrës Rajonale KMD Fier, znj. Aidana Hyka në kuadër të nismës "Ditët e Hapura Kunder Diskriminimit" këtë herë ishte në qytetin e Beratit, në të cilin u shpërndanë fletpalosje dhe kopje të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për të rritur ndërgjegjësimin dhe sensibilizimin e qytetarëve, në mënyrë që të referojnë ç'do lloj forme të diskriminimit !

Gjithashtu pati edhe një takim me Përfaqësuesen e Avokatit të Popullit në Berat, e Beratit





### KMD deklaratë për përfshirjen e të miturve në protestë



Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi po monitoron me shqetësim përfshirjen në protestat e ditëve të fundit në disa qytete të të miturve në akte dhune dhe shoqërimin e tyre në komisariate.

Përfshirja e të miturve në situata që degradojnë në përplasje të dhunshme me Policinë e Shtetit mund të rezultojë në përvoja traumatike, kundravajtje penale dhe me rrezikshmëri për integritetin e tyre fizik dhe psikologjik.

Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerëson që fëmijët e mitur të këshillohen nga familjarët e tyre për pasojat e përfshirjes në akte të dhunshme dhe incidente me policinë. Po ashtu, KMD i bën thirrje Policisë së Shtetit të zbatojë protokolle të veçanta për përballjen me të miturit në protesta apo shoqërime në rajone policore, duke ofruar shërbim të shtuar të punonjësve socialë dhe psikologëve. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi fton të gjithë qytetarët të ushtrojnë të drejtën e tyre kushtetuese për të protestuar në mënyrë paqësore.

### Ndërprerja e energjisë ndaj shtresave në nevojë, Dr. Gajda: Përçapje sporadike mes institucioneve

I ftuar në emisionin “Alert” në News24 nga Granit Sokolaj, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda ka folur për diskriminimin e shtresave në nevojë, duke u ndaluar tek rastet e ndërprerjes së energjisë elektrike të familjeve në pamundësi ekonomike për të paguar energjinë dhe mungesën e një akti nënligjor për t’u ardhur në ndihmë njerëzve në nevojë.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi foli edhe për aktin ligjor për rimbursimin e energjisë elektrike dhe mungesën e një legjislacioni që parashikon vendosjen e kontatorit pa pagesë për personat në pamundësi ekonomike.

Nxjerrja e aktit nënligjor duhet të limitohet jo vetëm në rimbursim, vendosja e kontratorëve duhet të jetë falas, rimbursim për energjinë e konsumuar dhe jo ndërprerje kur këto familje janë të pamundura të shlyejnë debinë dhe të pagujnë konsumin.

OSHEE ka zgjidhur sporadikisht, duhet të rregullohet situata. Jemi të fokusuar që të garantojmë parimin e barazisë dhe mosdiskriminimin”-deklaroi Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda.






Në Ditën Botërore kundër HIV/AIDS, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda çmon nevojën e përkujdesjes maksimale për njerëzit e prekur prej saj. Në ligjin e ri për Mbrojtjen nga Diskriminimi sigurohet një mbrojtje për personat me HIV. Pozicioni i Komisionerit për Diskriminim është forcuar pasi me ndryshimet e reja, të gjitha institucionet publike dhe entet private janë të detyruar të mbështesin punën e tyre duke dhënë të gjitha informacionet e kërkuara dhe

duke garantuar qasjen në informacion menjëherë.

Rreziku më i madh është të mos të dish, prandaj ne duhet të bashkojmë përpjekjet tona për të edukuar dhe ndërgjegjësuar, jo vetëm të rinjtë dhe të reja, por të gjithë qytetarët për sëmundjet e rrezishme seksualisht të transmetueshme siç ëshë SIDA! Zero infeksione të reja me HIV! Zero vdekje nga SIDA! Zero Diskriminimit



WWW.KMD.AL

**LUFTO HIV/AIDS,  
JO NJERËZIT ME  
AIDS!**

*Mëso. Vepro. Bëj Analizat*



## Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

**Kreu i KMD:**

**Z. Robert Gajda**

Komisioner për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është institucion i pavarur i Republikës së Shqipërisë. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin. Ai mbështetet nga Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), e cila ka personelin dhe pajisjet e nevojshme për të mbështetur Komisionerin në përmbushjen e detyrave të ngarkuara nga ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010.

**Për informacione të mëtejshme mbi aktivitetet:**

[www.kmd.al](http://www.kmd.al)

### **Zyra qendrore e KMD**

Rr: Rruga e Durrësit (Ish Ministria e Mjedisit)

Tirana, Albania

**Zip Code:** 1001

**E-mail:** [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)

**Tel:**

**Komisioneri:** + 355 4 243 1077

**Ankesa:** + 355 4 243 1078

### **Zyra rajonale:**

**Shkodër:** Pranë Bashkisë Shkodër, Rr.13 Dhjetori, Nr.1

Zip Code: 4001

Tel: + 355 4 243 1078

**Korçë:** Pranë Bashkisë Korçë Rr:28 Nentori Nr.1

Zip Code: 7001

Tel: + 355 4 243 1078

**FIER:** Pranë ADISA , Lagjia 11 Janari, “Shtëpia e Ushtarakëve”

Zip Code: 9301

Tel: + 355 4 243 1078